



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/128
Datë: 18.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet 120 dhe 121 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/128
Datë: 18.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST Sh.A. dhe Operatorit të Sistemit, të Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.A.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/128
Datë: 18.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore, që përcakton politikat sektoriale në:
 - 1.1. Sigurimin e të drejtave pronësore duke fuqizuar infrastrukturën ligjore;
 - 1.2. Sigurimin e të drejtave pronësore duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme;
 - 1.3. Garantimin dhe realizimin e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe komuniteteve jo-shumicë;
 - 1.4. Garantimin dhe realizimin e të drejtave pronësore të grave;
 - 1.5. Promovimin e shfrytëzimit produktiv të pronës së paluajtshme për nxitjen e rritjes ekonomike.
2. Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore zbatohet nga ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura, siç e përcakton Plani i Veprimit, që janë pjesë përbërëse e mekanizmit të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë.
3. Me qëllim të zbatimit efektiv të masave dhe veprimeve ndërsektoriale të dala nga kjo Strategji, themelohet Komiteti Drejtues për Implementimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore (në tekstin në vazhdim "Komiteti Drejtues") me qëllim koordinimin e implementimit të Strategjisë.
4. Komiteti Drejtues përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve si në vijim:
 - 4.1. Zëvendëskryeministri i Parë;
 - 4.2. Ministri i Drejtësisë;
 - 4.3. Ministri për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
 - 4.4. Ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
 - 4.5. Ministri për Administrimin e Pushtetit Lokal;
 - 4.6. Ministri i Financave;
 - 4.7. Ministri për Integrim Evropian;
 - 4.8. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
 - 4.9. Agjencia Kadastrale e Kosovës;

- 4.10. Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
 - 4.11. Agjencia Kosovare e Privatizimit;
 - 4.12. Agjencia për Barazi Gjinore;
 - 4.13. Përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë që ofrojnë asistencë teknike gjatë procesit të implementimit.
5. Komiteti Drejtues, sipas nevojës, mund të takohet në mënyrë *ad hoc* dhe në formate më të ngushta se sa përbërja e plotë varësisht temave që shtjellohen.
 6. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit Drejtues mund t'i delegojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre vartësve të tyre, varësisht temave që trajtohen.
 7. Komiteti Drejtues mbanë së paku dy takime në vit dhe ka detyrat si në vijim:
 - 7.1. Ofron institucioneve të përfshira në implementim të Strategjisë udhëzime mbi prioritetet për implementim;
 - 7.2. Rishikon, prioritetizon dhe validon propozimet për buxhetin vjetor lidhur me implementimin e Strategjisë;
 - 7.3. Adreson çështje ndërinstytucionale dhe të tjera, përfshirë identifikimin e problemeve gjatë implementimit;
 - 7.4. Shqyrton raportet vlerësuese për progresin mbi implementimin e Strategjisë.
 - 7.5. Propozon Qeverisë plotësimin apo ndryshimin e Strategjisë, politikave të sektorit dhe legjislacionit.
 8. Sekretariati i Komitetit Drejtues mbahet nga Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit, si dhe mbështetet nga Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave të Ministrisë së Drejtësisë.
 9. Sekretariati i Komitetit Drejtues ka detyrat si në vijim:
 - 9.1. Harton dhe propozon rregullat e procedurës për përcaktimin e agjendës dhe mbarëvajtjen e takimeve të Komitetit Drejtues;
 - 9.2. Ofron mbështetje teknike në organizimin e takimeve të Komitetit Drejtues;
 - 9.3. Përgatitë raporte 6 mujore që vlerësojnë progresin e arritjes së rezultateve të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë;
 - 9.4. Përgatitë raporte një vjeçare që vlerësojnë progresin e arritjes së objektivave të Strategjisë;
 - 9.5. Përgatitë raport afatmesëm të progresit, pas përfundimit të vitit të dytë zbatues të Planit të Veprimit dhe i ofron opsione Komitetit Drejtues për hapat e ardhshëm për implementim efektiv të Strategjisë.
 10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/128
Datë: 18.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 10, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokolli 3300/2 dhe 3300/3, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi dhe krijimi i detyrueshëm i servitutit për interes publik të pronave private dhe shoqërore, të cilat preken nga realizimi i Fazës së Tretë të Projektit për ndërtimin e "Fabrikës së Re të Ujit në Fshatin Shkabaj" Zona Kadastrale Shkabaj dhe Prishtinë, Komuna Prishtinë dhe Zonat Kadastrale Obiliq, Mazgit dhe Llazarevë, Komuna Obiliq, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike Qendrore "Kompania Ujësjellësi Rajonal (KUR) Prishtina - Sh.A".
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/128
Datë: 18.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 10, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokolli 3935 dhe 3935/2, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit dhe të Ndërtesave të ish NSH "Gërmia" Prishtinë, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, për nevoja të akomodimit të Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë